



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 5. 12.2018

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 93/2015, “PËR TURIZMIN”, TË
NDRYSHUAR””

HYRJE

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar”, në mbledhjen e datës 5 dhjetor 2018.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputeten Eglantina Gjermeni relatore për shqyrtimin e këtij projektligji.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar”, është një nismë e Këshillit të Ministrave, e cila i propozohet për shqyrtim Kuvendit bazuar në përcaktimet e nenit 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

I. QËLLIMI DHE PËRMBJATJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji është hartuar me qëllim propozimin e ndryshimeve në ligjin 93/2015. Ndryshimet e propozuara synojnë përjashtimin nga përfitimi i mbështetjes dhe lehtësive të parashikuara nga ky ligj, për personat e dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e disa veprave penale, kur ata janë investitorë/operatorë menaxhues, anëtarë të një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës, apo që kanë kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda investitorit/operatorit menaxhues.

Këto përjashtime bëhen me qëllim shmangien e çdo mundësie që këto subjekte/kategori, të fitojnë kontrata/marrëveshje publike.

Ky projektligj vjen në Kuvend si pjesë e një pakete të propozuar nga Këshilli i Ministrave për ndryshime në katër ligje: në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”; në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar”; në ligjin nr. 55/2015, “Për investimet strategjike”; në ligjin nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar””.

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”, në nenin 45 të tij e parashikon ndalimin e dhënies së kontratave publike, operatorëve ekonomikë të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, për një listë veprash penale. Por, referuar relacionit shoqërues të projektligjit, Këshilli i Ministrave bëri një analizë krahasuese të përcaktimeve të ligjit për prokurimin publik me parashikimin në direktivën 2014/24/EU të parlamentit evropian dhe të këshillit të 26 shkurtit 2014 “Mbi prokurimin publik”, që shfuqizon direktivën 2004/18/EU. Nga analiza rezultoi se ishte e nevojshme të bëhej një ndryshim në ligjin për prokurimin publik me qëllim përputhjen e plotë me direktivën. Përputhshmëria e plotë konsiston në shtimin e një parashikimi ligjor për përjashtimin nga mundësia për të përfituar fonde publike edhe për përfaqësuesit e operatorit ekonomik aksionar, ortakët, administratorët, përfaqësuesit ligjor etj., të dënuar me vendim të formës së prerë, si dhe në përditësimin e listës së veprave penale të parashikuara në direktivë, duke shtuar dhe disa vepra të tjera.

Me qëllim luftën ndaj kriminalitetit, Këshilli i Ministrave e shtriu këtë parashikim të zgjeruar dhe më gjithëpërfshirës, jo vetëm tek ligji për prokurimin publik por edhe në të tre ligjet e tjera të paketës.

II. SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJIT NË KOMISIONIN PËR VEPRIMTARITË PRODHUESE, TREGTINË DHE MJEDISIN

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision, relatorja vlerësoi rëndësinë që paraqesin ndryshimet e propozuara, në kuadër të përpjekjeve për të luftuar kriminalitetin në vend. Bërja e këtyre ndryshimeve në ligj do të shërbejë për të shmangur dhënien e kontratave/marrëveshjeve publike, të mirave publike dhe fondeve publike investorëve/operatorëve menaxhues të dënuar penalisht.

Anëtarët e komisionit diskutuan lidhur me nevojën për heqjen e mundësisë së përfitimit nga fondet publike, në sektorin e turizmit, nga persona të dënuar për kryerjen e disa lloj veprash penale, për shkak të vlerës së lartë të investimeve që investohet në këtë sektor.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me shumicë votash, e miratoi projektligjin në parim, nën nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm.

Gjatë shqyrtimit nën për nen, Komisioni, pasi u njoh edhe me raportin e Komisionit Parlamentar për Cështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, u shpreh dakord me propozimet e paraqitura prej tij, duke i bërë pjesë të vërejtjeve të tij si më poshtë:

1. Neni 1 të riformulohet si vijon:

“Neni 1

Në nenin 6, paragrafi numërohet me numrin 1 dhe pas tij shtohen pikat 2 e 3, me këtë përmbajtje:

“2. Përfshihet nga mbështetja dhe lehtësitë e parashikuara në kreun VI, të këtij ligji, çdo investitor/operator menaxhues, çdo person që është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i tij, aksionar ose ortak i investitorit/operatorit menaxhues, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse apo kontrolluese brenda tij, që është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

- a) Pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;
- b) Korrupsion;
- c) Mashtrim;
- ç) Pastrim parash ose financim i terrorizmit;
- d) Vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;
- dh) Organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit e shitjes së narkotikëve si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;
- e) Falsifikim;
- ë) Shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

3. Për përfitim të mbështetjes dhe të lehtësirave të parashikuara në kreun VI, të këtij ligji, subjektet e përcaktuara në pikën 2 duhet të paraqesin një vërtetim të gjendjes gjyqësore ose një dokument të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni.”.

RELATORE

KRYETAR

Eglantina GJERMENI

Eduard SHALSI